



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republika e Kosovës
Kuvendi i Komunës / Assembly of Municipality / Skupstina Opštine
SKENDERAJ

01

Nr. 110-20
No.

Data 30.03.2012
Date



Kuvendi i Komunës së Skenderajt
Skupstina Opštine Skenderaj
Municipal Assembly of Skenderaj

RREGULLORE
PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS NË LËMINË
E TREGËTISË, HOTELERISË, ZEJTARISË DHE SHËRBIMET
TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
SKENDERAJT

Skenderaj, me 30.03.2012

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 nën b të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës"), nr. 28/2008) të dispozitave të nenit 14.2 nën c të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 110 – 385 të datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur më datën 30.03.2012 e miratoi:

R R E G U L L O R E N

PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS NË LËMINË E TREGTISË, HOTELERISË, ZEJTARISË DHE SHËRBIMEVE TË TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SKENDERAJT

I. Dispozitat e përgjithshme.

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të organizatave biznesore në lëmin e: tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Skenderajt në bazë të nevojave dhe kërkesave të punonjësve dhe të qytetarëve.

Neni 2

Të gjitha organizatat biznesore të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat e Rregullores nr. 2008/26 për organizata biznesore: shoqëritë aksionare, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, bizneset individuale, ortakëritë etj, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

Orari i fillimit dhe mbarimit të punës, i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria. Duhet saktësuar orarin e punës para dite dhe pas dite, si dhe ditët që nuk punohet.

Neni 4.

Përcaktohet orari i punës në interval kohor:

Periudha verore fillon më 1 prill dhe zgjat deri më 30 shtator të vitit,

Periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe zgjat deri më 31 mars të vitit.

4.1 Orari i punës i dyqaneve zejtare fillon prej orës 08,00 deri 20,00

4.2 Furrat e bukës do të punojnë çdo ditë prej orës.....04,00 deri 22,00

Të dielave dyqanet zejtare nuk punojnë, përveç salloneve të ondulimit dhe kozmetikës.

4.3 Orari i punës i vetëshërbimeve, supermarketeve,

- në periudhën verore prej orës07,00 deri 22, 00
- në periudhën dimërore prej orës08.00. deri 21,00

Të dielave deri në ora11,00

4.4 Orari i punës i depove të artikujve ushqimorë dhe jo ushqimor.

- në periudhën verore prej orës.....08,00 deri 17,00 në
- periudhën dimërore prej orës.....08,00 deri 16,00.

4.5 Veprimtaritë prodhuese (fabrikat) punojnë me ndërime 24 orë.

Neni 5.

Hotelet, motelet do të punojnë :

- në periudhën verore prej orës00 deri 24,00
- në periudhën dimërore prej orës.....00. deri 24,00.

VËREJTJE: Pas orës 24.00 nuk lejohet shërbimi i mysafirëve jashtë objektit të hotelit, motelit.

Neni 6.

6.1 Kafe-baret, internet- kafetë, disko - klubet do të punojnë :

- në periudhën verore prej orës07,00 deri 23,00
- në periudhën dimërore prej orës.....08,00 deri 22,00

6.2 Restorantet, ëmbëltoret e të ngjashmet do të punojnë në këtë orar:

- në periudhën verore prej orës 07, 00 deri 24,00
- në periudhën dimërore prej orës..... 08.00 deri 23,00

Klubet e natës do të punojnë me këtë orar: gjatë periudhës verore dhe dimërore prej orës 23,00 deri 05,00

Veprimtaritë e lartpërmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, gjatë orarit të punës nuk mund t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të tyre, qoftë me muzikë apo me forma të tjera.

Neni 7

Tregjet e qytetit: **Tregu i gjelbër në Skenderaj, tregu i shitjes së veturave dhe tregu i bagëtive në Polac** do të punojnë me këtë orar:

- në periudhën verore prej orës 05,00 deri 18,00
- në periudhën dimërore prej orës 07,00 deri 17,00
- të shtunave prej orës..... 08,00 deri 16,00
- Tregu i kafshëve do të punojë të hënave prej orës 06,00 deri 15,00
- Tregu veturave do të punojë të **mërkurave** prej orës: 07,00 deri 15,00

Neni 8

Përfshirje nga dispozitat e nenit 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje bëjnë objektet që gjenden jashtë vendbanimeve dhe mund të punojnë më shumë se orari i punës, i përcaktuar me pëlqimin e Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 9.

Në objektet hoteliere, të cilat gjenden në afërsi të objekteve të banimit e në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio - video mjete për riprodhimin e programit, programi nuk mund të mbahet pas orës **22,00** me "afërsi të drejtpërdrejtë" kuptohet largësia 100 m nga objekti i banimit

Neni 10.

Objektet për shitjen e karburanteve do të punojnë në këtë orar:

- në periudhën verore dhe dimërore prej orës..... 06,00 deri 24,00
- Së paku dy pika shitjeje do të kujdestarojnë non-stop 24 orë, orarin e kujdestarisë do ta përcaktojnë organizatat biznesore të cilat merren me shitjen e karburanteve. Orari do të hartohet për 1 muaj dhe do t'i dorëzohet Inspektionit të Tregut në fund të muajit për muajin vijues.

Neni 11.

Barnatoret do të punojnë me këtë orar:

- për periudhën verore prej orës..... 08,00 deri 20,00

- për periudhën dimërore prej orës.....08,00 deri 19,00

Së paku dy barnatore do të punojnë non-stop 24 orë .Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojë vetë barnatorja . Orari do të hartohet për 1 muaj dhe to t'i dorëzohet Inspektionit të Tregut për muajin vijues .

Orari i kujdestarisë do të caktohet sipas alfabetit të mbishkrimeve të subjekteve afariste dhe të gjitha subjektet afariste kanë obligim që të vendosin orarin e kujdestarisë.

III. Zgjatja e orarit të punës

Neni 12.

Restorantet, kafe - baret, dyqanet hoteliere,vetëshërbimet , supermarketet , dyqanet tregtare, mund të punojnë më gjatë se orari i punës i përcaktuar me këtë Rregullore.

Për punën më të gjatë se orari i paraparë, duhet marrë pëlqimin e Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.

Për çdo orë pune më gjatë se orari i punës duhet paguar :

- objektet hoteliere (restorantet, kafe-baret,dyqanet hoteliere).....10,00 €.
- supermarketet, vetëshërbimet, dyqanet tregtare.....5,00 €.

Neni 13.

Organizata biznesore mund të zgjasin orarin e punës si në rastet:

- për festën kombëtare 28 Nëntori, deri në orën01,00
- për festat e marsit 5, 6 dhe 7 nata e zjarreve në Prekaz nga ora 18 deri në orën01,00
- për festat fetare : Bajrami i Madh, Bajrami i Vogël, Krishtlindjet, Pashkët etjderi në ora 01,00
- për festën e gruas 8 Marsi, orari zgjat deri në orën.....01,00
- për festën Shën Valentini, orari zgjat deri në orën.....01,00
- për festën e Vitit të Ri, orari zgjat deri në orën04,00
- për ditën e çlirimit të Skenderajt me 18 qershor, orari zgjat deri në orën.....01,00.

Për rastet e caktuara më lart nuk duhet të paguhet taksa dhe tarifa komunale.

Neni 14

Të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ-të) qe punojnë dhe veprojnë në territorin e komunës së Skenderajt do të punojnë prej orës 0816,00.

IV. Dispozitat ndëshkuese

Neni 15

Të gjitha organizatat biznesore, të cilat nuk do ta respektojnë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, të paraqitur në nenet 4.5.6.7 e i cili do të konstatohet nga Inspeksioni apo Policia, do të dënohen për kundërvajtje:

- personat juridikë 300 deri 400 €
- personat fizikë 150 deri 250 €

Neni 16

Të gjitha subjektet afariste të cilat do të konstatohet se kanë zgjatur orarin pa pëlqimin dhe Vendimin e Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, do të gjobiten për kundërvajtje:

- personat juridikë 250 deri 350 €
- personat fizikë 150 deri 250 €

V. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 17

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset : Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ndërsa mbikëqyrjen do ta bëjnë Sektori i Inspektionit – i Inspektori i tregut dhe Policia.

Neni 18

Personat juridikë, gjegjësisht themeluesit (Pronaret) e dyqaneve janë të obliguar që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, ditën e nesërme nga dita e hyrjes në fuqi të tekstit të spastruar të kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet rregullorja e mëparshme komunale e vitit 2003, që ka rregulluar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për organizatat biznesore .

Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt.

01 Nr. 110-20
Skenderaj, me 30.3.2012

KUVENDI I KOMUNËS
Kryesuesi
Ismet Salihu